



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07

**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 6 janar 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Mbajtjen e Seancës pa Praninë e të  
Akuzuarit**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësve të Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

**Mbrojtësve të Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman

Karl Bakli

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenin 39(5) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 92(2)(c) dhe 96(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 18 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi urdhër për mbajtjen e një seance më 8 janar 2021, në orën 15:00 ("Seanca"), e cila do të përfshinte seancën e vetëdeklarimit të Nasim Haradinajt ("z. Haradinaj") në lidhje me fajësinë ose pafajësinë dhe konferencën e parë për ecurinë e çështjes në këtë proces gjyqësor ("Urdhri për Caktim Date").<sup>2</sup>

2. Më 4 janar 2021, Mbrojtja e z. Haradinaj parashtroi kërkesë për mbajtjen e Seancës pa praninë e z. Haradinaj ("Kërkesa").<sup>3</sup> Kërkesës i bashkëlidhej një deklaratë e nënshkruar e z. Haradinaj, me të cilën konfirmonte pëlqimin e tij, pas këshillimeve me mbrojtësit, për të mos qenë i pranishëm në Seancë<sup>4</sup>.

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00089, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Seancës për Vetëdeklarim në lidhje me Fajësinë ose Pafajësinë dhe të Konferencës së Parë për Ecurinë e Çështjes dhe Çështje të lidhura me to* ("Urdhri për Caktim Date"), 18 dhjetor 2020, publik. Në seancën e paraqitjes së parë më 18 dhjetor 2020, z. Haradinaj nuk u vetëdeklarua në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e tij. *Shih* KSC-BC-2020-07, Transkript i seancës, 18 dhjetor 2020 (11:00), publik, f. 58, rreshtat 23-24 - f. 59, rreshtat 1-11.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00095, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Kërkesë për Mbajtjen e Konferencës për Çështjen pa Praninë e të Akuzuarit* ("Kërkesa"), 4 janar 2021, publike, para. 3-4, 9, 13.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00095/A01, 4 janar 2021, konfidenciale.

## II. LIGJI I ZBATUESHËM

3. Në bazë të rregullës 92(2)(c) të Rregullores, i akuzuari mund të pranojë fajësinë apo të vetëdeklarohet i pafajshëm për çdo akuzë, ose gjatë seancës së paraqitjes së parë, ose brenda 30 ditësh prej mbajtjes së saj. Sipas rregullës 92(2)(f) të Rregullores, në qoftë se gjatë paraqitjes së parë ose paraqitjeve vijuese, i akuzuari nuk vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën deklarin në emër të të akuzuarit se i akuzuari është i pafajshëm.

4. Në bazë të rregullës 96(2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit që jepet pas këshillimit me mbrojtësin, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit me praninë e mbrojtësit, ose pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës.

## III. DISKUTIM

5. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në Urdhrin për Caktim Date identifikohen dy pjesë të ndara të seancës: seanca e vetëdeklarimit të z. Haradinaj në lidhje me fajësinë ose pafajësinë (pjesa e parë), dhe konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes në këtë proces gjyqësor (pjesa e dytë).<sup>5</sup>

6. Në bazë të rregullës 92(2)(c) dhe (f) të Rregullores, është vetë i akuzuari ai që vetëdeklarohet, e shtyn vetëdeklarimin, ose refuzon të vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e tij. Kjo kërkon që i akuzuari të jetë i pranishëm, qoftë fizikisht apo nëpërmjet videokonferencës, në seancën përkatëse (të vetëdeklarimit). Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të domosdoshme të urdhërojë z. Haradinaj të jetë i pranishëm, qoftë fizikisht apo nëpërmjet videokonferencës, në

---

<sup>5</sup> Urdhri për Caktim Date, para. 19-20.

